



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1829/1 Prot.

Tiranë, më 13.03. 2025

URDHËR

Nr. 110, Datë 13.03. 2025

PËR

**NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020, TË
MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, "PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE
LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 20, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe urdhrin nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "*Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social*", i ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë:

a) Kudo në përmbajtje të urdhrin togfjalëshi "*Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*" zëvendësohet me togfjalëshin "*Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar*" dhe shkurtimi "*DPAP*" zëvendësohet me shkurtimin "*AKAP*".

b) Pas pikës 7, të Kreut IV, shtohet pika 7/1, me përmbajtje, si më poshtë:

"7/1. Përjashtimisht, në përbërje të Komisionit ad-hoc, të ngritur sipas pikës 7, të këtij Kreu, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për psikologë/punonjës socialë të cilët në aplikimin e tyre kanë përzgjedhur për punësim ZVAP Shkodër, Divjakë, Berat dhe Kolonjë, caktohet edhe nga 1 (një) përfaqësues nga bashkitë e përfshira në projektin pilot në ushtrimin e përgjegjësi në fushën e arsimit parauniversitar.

Kjo përbërje e komisionit ad-hoc zbatohet sipas kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MAS dhe Bashkisë përkatëse."

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Divjakë, Bashkia Kolonjë dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar në territorin e këtyre bashkive.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

